ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

A N K E S Ë

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**612-26-8159-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për : **Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra-projekt dy vjeçar 612-26-8159-5-1-1**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

GOE : "VALDRINI" SH.P.K & NNP NDERTIMI
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

DRENAS
(Adresa)

DRENAS
(Vendi)

13 000
(Kodi postar)

+383-49-623-188
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

QËNDRIM KURRUMELI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

valdrini.shpk@hotmail.com
(Adresa elektronike)

(Nënshkrimi dhe vula)

26/11/2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR VALDRINI Gllogoc

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: **N/A**

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**, me date **25.09.2026** ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: **Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar 612-26-8159-5-1-1,** si në vijim:

1. Procedurë e hapur,
2. Kontrate publike,
3. Punë, Vlerë e madhe
4. Vlera e parashikuar e kontratës: **650,000.00 euro**
5. Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët!
6.

Afati i fundit për dorëzim te tenderëve, ka qen me date: 04.11.2026 koha 13:30,
Vendi: **e-prokurimi.rksgov.**
Takimi për hapjen e tenderëve ka qen me datë: 04.11.2026 koha 13:30,ne platformën elektronikë te prokurimit.

Me date 16.11.2026 është publikuar B58 Vendimi i Autoritetit Kontraktues per dhënie te kontrates dhe letrat standarde për tenderuesin e Papërgjegjëshëm .Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për B42 Letrën standarde te tenderuesit te eliminuar.
Me date 20.11.2026 kemi bere kerkese per rishqyrtim pranë komunes së Mitrovices
Me date 24.11.2026 kemi pranuar vendimin nga AK. mbi refuzimin e kërkeses per rishqyrtim si të pa bazuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderit është bërë në mënyrë elektronike në vendin e caktuar dhe ne kohen e caktuar, me 04.11.2026 koha 13:30. Nuk kemi vërejtjeje!

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin e AK- Autoriteti kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË** dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë Ankesë kundër;

- **Njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te Papërgjegjëshëm) nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit.**
- **Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës : 16.11.2026**

Prandaj te pa kënaqur me Vendimin e AK-Autoritetit kontraktues-**KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**,Për shkak të shkelje të dispozitave të;

- Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;
- Nenin 1, Qëllimi, par 1 dhe 3.

- Nenin 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.
- Nenin 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6
- Neni 10, Qasja në dokumentacion
- Nenin 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, par 1, nen par 1.1 ; 1.2 dhe par 3.
- Nenin 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe 4
- Nenin 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1
- Nenin 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, par 1.
- Nenin 72 të LPP-së, të Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, par 1 dhe 2.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Nenin 38, Sqarimi i Tenderëve, par 38.1
- Nenin 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a; b dhe c
- Nenin 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen (d) dhe (o)

III. Dispozitat e Udhëzuesit nr. 01/2023 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi UA2) dhe atë:

- 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: **Sa i përket Formulari Letrës standarde për tenderues te ELIMINUAR.**

E kundërshtojmë në tërësi vendimin e AK lidhur me letrën standarde për tenderues te Papërgjegjëshëm, për faktin se arsyetimi i AK sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pa bazuar dhe në shkelje të kërkesave te përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT dhe në shkelje të dispozitave Ligjore të LPP-së.

Autoriteti kontraktues **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË** me date 16.11.2026 ka derguar vendimin dhe letren standarde ne te cilen ka propozuar per shperblim me kontrate operatorin ekonomik : **V-SHEHU SH.P.K** me çmimin total te ofertes : 599,438.00 €.Ak. ka bere shkelje te rregulloreve te prokurimit publik sepse OE : V-SHEHU SH.P.K i rekomanduar per kontrate është i papergjegjshem sepse nuk ka plotesuar kerkesat e AK ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate, dhe poashtu dyshojme se ka perdorur dokumente jo valide dhe pa autorizim kete e argumenton deklarata e noteruar e inxhinierit te mbrojtjes se mjedisit e cila i eshte percjellur Ak komuna Fushe Kosove permes emailit.

Pretendimet tona lidhur me OE:V-SHEHU SH.P.K te rekomanduar per fitues janë :

1)PRETENDIMI I PARË : Operatori Ekonomik V-SHEHU Sh.p.k ne oferten e tij ka prezantuar **Marrëveshje Bashkëpunimi(parakontratë)** me Inxhinierin e Mbrojtjes së Mjedisit, **Z. Vehbi Goxhuli**, së bashku me dokumentet e tij profesionale (diploma,licensa, certifikata, CV, etj.),pa dijenine e inxhinierit z.Vehbi Goxhuli, me kete rast po paraqesim kërkesën për eliminimin e menjëhershëm të Operatorit Ekonomik **"V-Shehu shpk"** nga gara e mëtutjeshme në procedurën e tenderimit për aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar 612-26-8159-5-1-1**, për shkak të shkeljeve të rënda ligjore dhe prezantimit të të dhënave të rreme në ofertën e tij.

Arsyetimi i Shkeljes:

Gjatë procesit të verifikimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dorëzuar nga OE "V-Shehu shpk", është konstatuar nga komisioni vlersues se ky operator ka përfshirë në ofertën e tij një **Marrëveshje Bashkëpunimi(parakontratë)** me Inxhinierin e Mbrojtjes së Mjedisit, **Z. Vehbi Goxhuli**, së bashku me dokumentet e tij profesionale (diploma,licensa, certifikata, CV, etj.).

Pas kontaktimit dhe verifikimit të drejtpërdrejtë me email zyrtar nga antari i komisionit vlersues te ofertave, vetë inxhinieri **Z. Vehbi Goxhuli ka konfirmuar zyrtarisht me email se NUK ka asnjë marrëveshje bashkëpunimi** me këtë operator ekonomik(**V-SHEHU SH.P.K**). Dorëzimi i dokumenteve të tij dhe nënshkrimi i marrëveshjes është bërë tërësisht pa dijeninë, pa autorizimin dhe pa pëlqimin e tij, duke e bërë këtë marrëveshje plotësisht **të pavlefshme (jo valide)** dhe me elemente të falsifikimit.Deshmi per kete qeshtje jane: Kerkesa nga antari i komisionit vlersues per informim me email zyrtar,pergjigjia e inxhinierit Vehbi Goxhuli me email ,Deklarata e inxhinierit me email drejtuar autoritetit kontraktues dhe kompanise tone Valdrini sh.p.k. si OE pale interesi ne kete aktivitet prokurimi.

Baza Ligjore për Eleminimin e OE: V-SHEHU Sh.p.k :

Në bazë të Legjislacionit të Prokurimit Publik në fuqi, prezantimi i të dhënave të rreme, mashtrimi apo dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara/pa autorizim me qëllim plotësimin e kritereve të kapacitetit teknik dhe profesional, përbën bazë absolute për eleminim të menjëhershëm të Operatorit Ekonomik. Konkretisht:

- **OE "V-Shehu shpk" ka dështuar të dëshmojë kapacitetin e kërkuar profesional në mënyrë të ligjshme.**

- **Përdorimi pa autorizim i identitetit dhe dokumenteve të një pale të tretë cenon parimin e ndershmërisë dhe transparencës në prokurim publik.**

Kërkesa:

Mbështetur në deklaratën e noteruar dhe konfirmimin e **Z. Vehbi Goxhuli**, kërkojmë nga OSHP që të marrë vendim për **eliminimin e menjëhershëm të OE "V-Shehu shpk"** nga ky aktivitet prokurimi dhe të shqyrtohen masat e mëtutjeshme ligjore sipas rregullave në fuqi.

VEREJTJE: AK.ka dhene qasje ne keto dokumente por te njejtat i ka shlyer identitetin e inxhinierit te mbrojtjes se mjedisit Vehbi Goxhuli , dhe ka shlyer nenshkrimin e dyshuar.Pasiqe dokumentet profesionale(diploma,Cv,licensa,referenca etj) te ing Vehbi Goxhuli i kemi paraqitur edhe ne ne oferten tone atehere duke bere krahasimin korrespondon se jane te njejtat dokumente.Ne kete rast eshte e qarte se eshte perdorur ky ing. Pa autorizim dhe Pa pelqimin e tij nga OE i shpallur fitues .Kete e deshmojne me se miri emailat e shkembyer ndermjet komisionit vlersues te AK dhe Inxhinierit te mbrojtjes se mjedisit Vehbi Goxhuli , dhe po ashtu kete e deshmon sakt deklarata e inxhinierit Vehbi Goxhuli e cila eshte e noteruar per arsye te transparences ne te cilen thuhet qarte se i eshte keqperdorur(falsifikuar) nenshkrimi i tije dhe i jane keqperdorur dokumentet profesionale te tije pa autorizim dhe pa pelqim te tij nga OE: V-Shehu shpk. Deshmi per kete falsifikim ju dergojme emailat e shkembyer,deklarata/informimet e noteruara.

2)PRETENDIMI I DYTË: Ne dosjen e tenderit kerkohet : **Kërkesa numër 1. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 975 000.00 euro. Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar te kontratave te natyres se ngjajshme. Dëshmitë për kërkesën numër 1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar numrin e prokurimit, vleren e kontrates, daten te percjella me referenca certifikata perkatese ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje.**

-OE ka ofruar nje liste te kontratave te realizuara ne tri vitet e fundit e cila nuk permban numrin e prokurimit per kontratat e realizuara respektivisht per kontratat ne institucionet publike.OE:V-SHEHU Sh.p.k nuk ka arritur te plotesoj plotesisht kete kerkese te AK ne dt Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar numrin e prokurimit.

3)PRETENDIMI I TRETË: Ne dosjen e tenderit kerkohet : Kërkesa numër 2. Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt ne pozita te ndryshme profesionale (min. 15 punetore). Dëshmitë për kërkesën numër 2.Një pasqyrë tabelare e personelit Emrin,Mbiemrin,Profesionin,Pervoja dhe **pozicioni** të angazhuar me parakontratë në kompani , duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga OE.

-OE ka ofruar nje Liste të puntoreve e cila është e paplotësuar në teresi, mungon plotesimi i pozicionit te 15 punetoreve. OE:V-SHEHU Sh.p.k nuk ka arritur te plotesoj plotesisht kete kerkese te AK ne dt.

4)PRETENDIMI I KATËRT: Ne dosjen e tenderit kerkohet: **Kërkesa numër 4. Operatori Ekonomik duhet te ketë Gurëthyes te licencuar ne pronësi apo Marrëveshje për furnizim me zhavor., Dëshmitë për kërkesën numër 4.Licenca apo leja e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale kopje , (marrveshja te jete e orgjinal dhe per kete projekt) .**

- Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik (OE: V-Shehu shpk), është konstatuar se OE ka paraqitur një marrëveshje për furnizim, mirëpo në përmbajtjen e saj nuk është specifikuar dhe definuar lloji i materialit apo produktit që do të jetë objekt i furnizimit. Duke qenë se në Dosjen e Tenderit, në mënyrë të qartë është kërkuar marrëveshje për furnizim me zhavor, dokumenti i paraqitur nga OE: V-Shehu shpk nuk dëshmon përmbushjen e këtij kriteri, pasi që nuk përmban ndonjë përcaktim konkret se marrëveshja ka të bëjë me furnizimin me zhavor.
Një marrëveshje e përgjithshme për furnizim, pa specifikimin e materialit të kërkuar, nuk mund të konsiderohet dëshmi e mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Rrjedhimisht, konsiderojmë se Operatori Ekonomik V-Shehu shpk nuk ka dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar, pasi dokumentacioni i dorëzuar nuk përputhet me kërkesën konkrete të Autoritetit Kontraktues.Marrëveshja e paraqitur nuk mund të pranohet si dëshmi e përmbushjes së kriterit për furnizim me zhavor, për shkak se objekti i furnizimit nuk është përcaktuar në marrëveshje.

5) PRETENDIMI I PESTË : PRETENDIMI ANKIMOR LIDHUR ME QASJEN E PJESSHME NË DOKUMENTE DHE DYSHIMET PËR PARREGULLSI NË VLERËSIM

Në cilësinë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, ne kemi ushtruar të drejtën tonë ligjore për qasje në dokumentet e OE : V-SHEHU Sh.p.k pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Fushë Kosovës, në përputhje me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), të ndryshuar dhe plotësuar.
Mirëpo, Autoriteti Kontraktues na ka lejuar qasje vetëm pjesërisht në dokumentacionin e kërkuar për Operatorin Ekonomik të shpallur fitues, **"V-Shehu" SH.P.K.** Në dokumentet e dërguara, një pjesë e konsiderueshme e të dhënave dhe identiteteve janë mbuluar (redaktuar) në mënyrë të paarsyeshme, duke pamundësuar verifikimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar apo ka shmangur dërgimin e dokumenteve kyçe që dëshmojnë kualifikimin teknik dhe profesional të operatorit fitues, e konkretisht:

- Dëshmitë e pronësisë apo posedimit të pajisjeve të kërkuara sipas Dosjes së Tenderit;
- Marrëveshjet ose kontratat e bashkëpunimit/qirasë me operatorët e tjerë ekonomikë për sigurimin e këtyre pajisjeve;
- Kërkesat për sqarime të dërguara nga Autoriteti Kontraktues tek Operatori Ekonomik fitues "V-Shehu" SH.P.K., si dhe përgjigjet/sqarimet e pranuara nga ky operator gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Kufizimi i qasjes në këto dëshmi thelbësore dhe fshehja e të dhënave pa bazë ligjore për konfidencialitet bien ndesh me Nenin 10 (Qasja në Dokumente) dhe Nenin 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) të LPP-së. Mosdhënia e plotë e dokumentacionit të lartcekur – veçanërisht e dëshmive për pajisje, marrëveshjeve me palët e treta dhe shkresave sqaruese – **ngjall dyshime serioze dhe të bazuara mbi ligjshmërinë dhe integritetin e këtij procesi të vlerësimit, pasi ekziston rreziku real se në dosjen e operatorit të shpallur fitues mund të jenë dorëzuar dokumente të rreme, të pasakta ose të pamjaftueshme** për të përmbushur kriteret e përzgjedhjes, të cilat Autoriteti Kontraktues po tenton t'i mbajë të fshehura nga shqyrtimi publik dhe nga operatorët ankues.
Andaj, kërkojmë nga Eksperti shqyrtues dhe Paneli shqyrtues i Oshp-së që në kuadër të shqyrtimit të kësaj Ankese, të rishikojë tërësisht vlerësimin e ofertës së "V-Shehu" SH.P.K., të verifikojë vërtetësinë e secilës dëshmi për pajisje dhe marrëveshjeve përkatëse.

Dhe si përfundim të nxjerr:

VENDIM

Me të cilin të vendim të kerkojme nga OSHP që te aprovoj ankesen tonë të bazuar të paraqitur nga *GOE* : **"VALDRINI" SH.P.K & NNP NDERTIMI** ,Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat prokurimit publik në Kosovë,

- ✓ Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat prokurimit publik në Kosovë,
- ✓ Të anuloj njoftimin mbi vendimin e AK-së - B58

Të shpërblej me kontratë *GOE* :**"VALDRINI" SH.P.K & NNP NDERTIMI,**sepse është i përgjegjshëm sipas kritereve të përzgjedhjes dhe të vlerësimit dhe ka ofruar çmim me te lirë ne mesin e tenderëve të përgjegjshëm.
Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt, Qëndrim Kurrumeli

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime administrative. Shpenzimet e ankesës 500.00 €, Fitimi i humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

BASHKANGJITUR GJENI DESHMITË TONA TE NEVOJSHME LIDHUR ME KËTË AKTIVITET TE PROKURIMIT.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY

UNIREF

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT

PPQDD111111111H

Të dhënat e OE Podaci EO EO data	Valdrini sh.p.k, FEHMI LLADROVCI BLLOKU 7 BANESA 4, 13000 GLLOGOC
Përshkrimi Opis Description	Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar
Numri i prokurimit Broj nabavke Procurement number	612-26-8159-5-1-1
Shuma / Iznos Ammount	€ 6500 Euro 00 Ct Data / Datum / Date 26 11 26
Me fjalë / Rečima In words	
Xhirollogaria Broj žiroračuna Bank account	1000430070005756
Lëshuar nga Izdato od / Issued by	OSHP

BANKA EKONOMIKE SHA
26 -11- 2026

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife te ankesave ne OSHP. a. Kurdo qe ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim te një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro. b. Kurdo qe aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës se parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.	14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN. a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €. b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.

Banka Ekonomike
www.bekonomike.com

Numri unik: ZAAF261126152410

Valuta	
EUR	
USD	
CHF	
GBP	

Numri i Llogarisë: 9253

Emri i Llogarisë: ORGANI SHQYRTUES i PROKURIMIT

Apoena	Numër
1,000	
500	
200	
100	
50	
20	
10	
5	
2	
1	
0.5	
0.2	
0.1	
0.05	
0.02	
0.01	

Emri i Paguesit: VALDRINI SHPK
Qëllimi i Pagesës: pagese per depozite per sigurim te ankeses 612-26-8159-5-1-1;
Emri dhe mbiemri: VALDRINI SHPK
Kompania: OSHP
Përshkrimi: PAGESE PER DEPOZITE PER SIGURIM TE ANKESES 612-26-8159-5-1-1
UNIREF: PPQDD1111111111H

BANKA EKONOMIKE SH.A.
26 -11- 2026
Nëndega Drenas
Arka nr. 161
1061

Nga llogaria: 1401000000628545 - VALDRINI SH.P.K.

Valuta: EUR Provizion:1.50 Total Shuma: 6501.5

Shuma me fjalë: Gjashtë mijë e pesë qind e një e Pesëdhjetë cent

Data Pagesës: 26.11.2026 Arkatari: Samile Shala Nënshkrimi i Klientit: _____.

Unë / Ne deklaroj/më se ky transakcion ka prejardhje nga biznesi legal dhe nuk përdoret për të fshehur ose mbuluar ndonjë prejardhje jolegale.
We hereby declare that this transaction is obtained from a legal business/origin and is not indented to hide or cover any illegal origin.

Outlook

Deklarate/Informing i noteruar

From Vehbi Goxhuli <vehbigoxhuli@gmail.com>
Date Tue 11/24/2026 2:25 PM
To ismete.prebreza@rks-gov.net <ismete.prebreza@rks-gov.net>
Cc bahrije.hasolli@rks-gov.net <bahrije.hasolli@rks-gov.net>; izja.mjeku@rks-gov.net <izja.mjeku@rks-gov.net>; valdrini.shpk@hotmail.com <valdrini.shpk@hotmail.com>

1 attachment (967 KB)
IMG_8596_ca4ef413-7617-4e4f-8295-57aa2bc65e9c.pdf;

Pershendetje

Po ju dergoj deklaratat/informimet mbi keqperdorimin e nenshkrimit dhe dokumenteve profesionale lidhur me projektin : Ndertimi I kanalizimeve female ne Fushe Kosove dhe fshatra projekt dy vjeqar me nr.prokurimi: 612-26-8159-5-1-1.

Deklarata dhe informimi jane te noteruara nga origjinali me qellim te transparences.

Me respekt
Inxhinier I mjedisit
VEHBI GOXHULI
TEL: +38349380301

DEKLARATË / INFORMIM

MBI KEQPËRDORIMIN E NËNSHKRIMIT DHE DOKUMENTACIONIT PROFESIONAL

Informimi bëhet për Autoritetin kontraktues komuna Fushë Kosovë: Zyres ligjore ,zyres se prokurimit dhe zyres se kryetarit.

Unë, Vehbi Goxhuli me nr.personal:1004382583, në cilësinë e inxhinierit të mjedisit, me përgjegjësi të plotë ligjore dhe morale, deklaroj si në vijim:

Deklaroj se nënshkrimi im personal dhe dokumentet e mia profesionale janë përdorur pa autorizimin dhe pa pëlqimin tim nga Operatori Ekonomik:**V-SHEHU SHPK,** në kuadër të aktivitetit të prokurimit me titull:

"Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra – Projekt dy vjeçar"

Nr. i prokurimit: 612-26-8159-5-1-1,Komuna Fushë Kosovë.

Sqaroj se nuk kam dhënë autorizim, pëlqim apo miratim për përdorimin e nënshkrimit tim dhe dokumentacionit tim profesional nga OE V-SHEHU SHPK për qëllimet e këtij aktiviteti të prokurimit.

Gjithashtu, deklaroj se nuk kam lidhur marrëveshje apo ndonjë raport kontraktual me OE: V-SHEHU SHPK për angazhimin tim profesional në këtë projekt dhe nuk kam autorizuar asnjë person që të nënshkruajë apo të përdorë dokumente në emrin tim lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.Prandaj ju informoj se nenshkrimi im është falsifikuar ne Parakontrate pune dhe dokumentet e mija profesionale(Cv,diploma,licensat,referencat etj) jane keqperdorur ne kete aktivitet te prokurimit nga OE: V-Shehu Shpk.

Përmes kësaj deklarate, distancohem nga çdo marrëveshje(parakontrate),dokument, apo zotim profesional që është paraqitur në emrin tim nga OE V-SHEHU SHPK në kuadër të këtij tenderi, pa dijeninë dhe pa pëlqimin tim.

Kërkoj që kjo deklaratë të merret parasysh nga Autoriteti Kontraktues komuna Fushë Kosovë dhe organet kompetente gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit, si dhe të ndërmerren veprimet përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklaroj se të gjitha pohimet e paraqitura në këtë dokument janë të vërteta dhe mbaj përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e kësaj deklarate.

Data: 24 / 11/ 2026

DEKLARUESI:

Vehbi Goxhuli

Nënshkrimi: Vehbi Goxhuli

REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER

ALBAN S. JANOVA

GLLOGOC

ERR.nr.4329/2026

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT

Unë Alban S. Janova , noter në Gllogoc, rruga"Fehmi dhe Xhevë Lladrovci" nr. [illegible] vërteton se: ----------

Nënshkrimi i vendosur në dokumentin e bashkëngjitur këtij akti,me titull „Deklaratë/Informim", është vënë nga vetë deklaruesi. ----------

Vehbi Goxhuli, i lindur më datë 02.10.1966 (dy tetor një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë), në Makërmal, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftimin nr. ID1183512, me numër personal 1004382583, të lëshuar më datë 28.01.2019, me afat vlefshmërie deri më datë 27.01.2029, nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës (MPB), me zotësi të plotë për të vepruar, me vendbanim në rrugën „Bushatllinjtë", nr. 57, Mitrovicë. ----------

Akti i përpiluar dhe i sjellë nga pala është shprehje e vullnetit të palës dhe Noteri nuk merr përgjegjësin për përmbajtën apo gabimet eventuale teknike në akt, Noteri jep përgjegjësin vetëm për vërtetësinë e nënshkrimit të vendosur në dokumentin e bashkangjitur të këtij akti qe është vene nga pala ne prezencën e noterit. ----------

Noteri në zbatim të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i kërkoi leje palës mbi të drejtën e përdorimit të të dhënave të tij në këtë akt noterial, i njëjti e lejon noteren që t'i përdor të gjitha të dhënat e tij sipas dokumenteve personale dhe të arkivohen në arkivën e Noterit.----------

Në përputhje me nenin 48 të Ligjit nr. 06/L-10 për Noterinë, Noteri konstaton se pala ka nënshkruar dhe vulosur dokumentin në praninë e saj. Akti i vërtetimit është përpiluar në nje faqe dhe nje fletë. --------

Kompensimi për punën dhe kompensimi për shpenzimet është i llogaritur sipas tarifës noteriale në kuptim të nenit 16 LNK dhe 20 nenit 31 paragrafi 2 dhe nenit 42 të UA nr. MD-Nr.05/2022 për Tarifat Noteriale për Kompensimin për Punën dhe Kompensimin e Shpenzimeve, në vlerë prej **1.10€**.+18% tvsh 1.29 faqe jan te noterizuar tri kopje euro----------

Veprimi I noterizimit u bë ne Gllogoc, në zyrën e noterit me datën më lartë e katër nëntor dy mijë e njëzet e gjashtë (24.11.2026) ora 12:50.----------

----------**Noteri Alban S. Janova**----------

Akt i Noterisë

Data: 18/11/2026

INFORMACION / DEKLARATË

Lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit për projektin e kanalizimeve fekale

Për: Valdrini SH.P.K.

Nga: Vehbi Goxhuli, Inxhinier i Mjedisit

Lënda: Informim lidhur me marrëveshjen valide të bashkëpunimit për projektin me nr. të prokurimit 612-26-8159-5-1-1

Të nderuar,

Unë, Vehbi Goxhuli, Inxhinier i Mjedisit, përmes kësaj shkrese dëshiroj t'ju informoj lidhur me një komunikim që kam pranuar nga zyrtarët e Komunës së Fushë Kosovës.

Përmes një emaili, zyrtarët e Komunës së Fushë Kosovës më kanë kërkuar sqarim se me cilin operator ekonomik kam marrëveshje valide bashkëpunimi si Inxhinier i Mjedisit për projektin "Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra – projekt dyvjeçar", me numër prokurimi 612-26-8159-5-1-1. Në këtë komunikim janë përmendur operatorët ekonomikë Valdrini SH.P.K. dhe V-Shehu SH.P.K., pasi, sipas informatave të përcjella nga zyrtarët, të dy operatorët kanë ofertuar në këtë tender duke paraqitur marrëveshje me mua në cilësinë e Inxhinierit të Mjedisit.

Në përgjigjen time kam sqaruar qartë se për projektin e lartcekur kam marrëveshje bashkëpunimi valide vetëm me kompaninë Valdrini SH.P.K. Me kompaninë V-Shehu SH.P.K. nuk kam lidhur dhe nuk kam nënshkruar asnjë marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt.

Për këtë arsye, ju informoj se, sipas deklarimit tim, marrëveshja e vetme valide e bashkëpunimit për angazhimin tim si Inxhinier i Mjedisit në këtë projekt është ajo e lidhur me Valdrini SH.P.K. Gjithashtu, duke pasur parasysh se në procedurën e prokurimit është paraqitur edhe emri im nga operatori ekonomik V-Shehu SH.P.K., kam dyshime se nënshkrimi dhe/ose dokumentacioni im mund të jenë përdorur pa autorizimin dhe pëlqimin tim. Këtë çështje e bëj të ditur për transparencë dhe për dijeninë tuaj, pa paragjykuar konstatimin e organeve kompetente.

Kjo shkresë lëshohet me qëllim të informimit të kompanisë Valdrini SH.P.K. dhe të evidentimit të qëndrimit tim lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit për projektin në fjalë.

Me respekt,

Vehbi Goxhuli

Inxhinier i Mjedisit
Nënshkrimi: Vehbi Goxhuli

Nr. kontaktues: +38349380301

REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER

ALBAN S. JANOVA

GLLOGOC

LRP.nr.4330/2026

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT

Unë Alban S. Janova , noter në Gllogoc, rruga"Fehmi dhe Xhevë Lladrovci "nr. 15 , vërteton se: ---------- **Nënshkrimi i vendosur në dokumentin e bashkëngjitur këtij akti,me titull „INFORMACION/ DEKLARATË", është vënë nga vetë deklaruesi.** ----------

-Vehbi Goxhuli, i lindur më datë 02.10.1966 (dy tetor një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë), në Makërmal, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftimin nr. ID1183512, me numër personal 1004382583, të lëshuar më datë 28.01.2019, me afat vlefshmerie deri më datë 27.01.2029, nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës (MPB), me zotësi të plotë për të vepruar, me vendbanim në rrugën „Bushatllinjtë", nr. 57, Mitrovicë. ----------

Akti i përpiluar dhe i sjellë nga pala është shprehje e vullnetit të palës dhe Noteri nuk merr përgjegjësin për përmbajtën apo gabimet eventuale teknike në akt, Noteri jep përgjegjësin vetëm për vërtetësinë e nënshkrimit të vendosur në dokumentin e bashkangjitur të këtij akti qe është vene nga pala ne prezencën e noterit. ----------

Noteri në zbatim të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i kërkoi leje palës mbi të drejtën e përdorimit të të dhënave të tij në këtë akt noterial, i njëjti e lejon noteren që t'i përdor të gjitha të dhënat e tij sipas dokumenteve personale dhe të arkivohen në arkivën e Noterit.----------

Në përputhje me nenin 48 të Ligjit nr. 06/L-10 për Noterinë, Noteri konstaton se pala ka nënshkruar dhe vulosur dokumentin në praninë e saj. Akti i vërtetimit është përpiluar në nje faqe dhe nje fletë. --------

Kompensimi për punën dhe kompensimi për shpenzimet është i llogaritur sipas tarifës noteriale në kuptim të nenit 16 LNK dhe 20 nenit 31 paragrafi 2 dhe nenit 42 të UA nr. MD-Nr.05/2022 për Tarifat Noteriale për Kompensimin për Punën dhe Kompensimin e Shpenzimeve, në vlerë prej **1.10€**..+18% tvsh 1.29 faqe jan te noterizuar tri kopje euro----------

Veprimi I noterizimit u bë ne Gllogoc, në zyrën e noterit me datën njëzetë e katër nëntor dy mijë e njëzet e gjashtë (24.11.2026) ora 12:50.----------

----------**Noteri Alban S. Janova** _____

Akti i Noterisë së Kosovës

Outlook

Re: Kërkesë

From Vehbi Goxhuli <vehbigoxhuli@yahoo.com>
Date Wed 11/18/2026 3:51 PM
To vehbigoxhuli@gmail.com <vehbigoxhuli@gmail.com>;
valdrini.shpk@hotmail.com <valdrini.shpk@hotmail.com>
Cc nexhat.bajqinca@rks-gov.net <nexhat.bajqinca@rks-gov.net>;
ismete.prebreza@rks-gov.net <ismete.prebreza@rks-gov.net>

1 attachment (75 KB)
Informim i nenshkruar nga Vehbi_Goxhuli_Valdrini_SH.P.K..pdf;

Dërgim i deklaratës për konfirmimin e marrëveshjes së bashkëpunimit – Prokurimi nr. 612-26-8159-5-1-1

Të nderuar,

Ju lutem, gjeni të bashkëngjitur ne atachmentin e këtij emaili deklaratën përmes së cilës konfirmohet marrëveshja e bashkëpunimit profesional ndërmjet Operatorit Ekonomik **"Valdrini" SHPK** dhe Ekspertit per Inxhinjerin ne Mbrojtjen e Mjedisit -**Mr. Inxh. Dipl. Vehbi Goxhuli**, në cilësinë e **Inxhinierit/Ekspertit të Mbrojtjes së Mjedisit**, për aktivitetin e prokurimit me titull:

"Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra përreth" – Projekt dyvjeçar"

Numri i prokurimit: 612-26-8159-5-1-1
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Fushë Kosovës.

Përmes kësaj marrëveshjeje, Operatori Ekonomik **"Valdrini" SHPK** konfirmon angazhimin tim profesional si **Ekspert/Inxhinier i Mbrojtjes së Mjedisit, me kualifikim**

Magjister i shkencave teknike në Inxhinieri të Mbrojtjes së Mjedisit, për ofrimin e shërbimeve profesionale fushen e Inxhinjeris se Mjedisit dhe ekspertizës përkatëse gjatë realizimit të projektit të sipërpërmendur.

Deklarata e bashkëngjitur paraqet konfirmimin formal të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe angazhimit profesional për qëllimet e këtij aktiviteti të prokurimit.

Ju falënderoj për perkrahje profesionale, bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Me respekt,

Mr. Inxh. Dipl. Vehbi Goxhuli
Ekspert/Inxhinier i Mbrojtjes së Mjedisit

Tel.: +383 49 380 301
Tel.: +383 44 330 322
E-mail: vehbigoxhuli@yahoo.com
E-mail: vehbigoxhuli@gmail.com

On Tuesday, November 10, 2026 at 03:45:09 PM GMT+1, Vehbi Goxhuli <vehbigoxhuli@yahoo.com> wrote:

Yahoo Mail: Search, Organize, Conquer

On Tue, Nov 10, 2026 at 9:15, Nexhat Bajqinca <Nexhat.Bajqinca@rks-gov.net> wrote:

Data: 18/11/2026

INFORMACION / DEKLARATË

Lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit për projektin e kanalizimeve fekale

Për: Valdrini SH.P.K.

Nga: Vehbi Goxhuli, Inxhinier i Mjedisit

Lënda: Informim lidhur me marrëveshjen valide të bashkëpunimit për projektin me nr. të prokurimit 612-26-8159-5-1-1

Të nderuar,

Unë, Vehbi Goxhuli, Inxhinier i Mjedisit, përmes kësaj shkrese dëshiroj t'ju informoj lidhur me një komunikim që kam pranuar nga zyrtarët e Komunës së Fushë Kosovës.

Përmes një emaili, zyrtarët e Komunës së Fushë Kosovës më kanë kërkuar sqarim se me cilin operator ekonomik kam marrëveshje valide bashkëpunimi si Inxhinier i Mjedisit për projektin "Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra – projekt dyvjeçar", me numër prokurimi 612-26-8159-5-1-1. Në këtë komunikim janë përmendur operatorët ekonomikë Valdrini SH.P.K. dhe V-Shehu SH.P.K., pasi, sipas informatave të përcjella nga zyrtarët, të dy operatorët kanë ofertuar në këtë tender duke paraqitur marrëveshje me mua në cilësinë e Inxhinierit të Mjedisit.

Në përgjigjen time kam sqaruar qartë se për projektin e lartcekur kam marrëveshje bashkëpunimi valide vetëm me kompaninë Valdrini SH.P.K. Me kompaninë V-Shehu SH.P.K. nuk kam lidhur dhe nuk kam nënshkruar asnjë marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt.

Për këtë arsye, ju informoj se, sipas deklarimit tim, marrëveshja e vetme valide e bashkëpunimit për angazhimin tim si Inxhinier i Mjedisit në këtë projekt është ajo e lidhur me Valdrini SH.P.K. Gjithashtu, duke pasur parasysh se në procedurën e prokurimit është paraqitur edhe emri im nga operatori ekonomik V-Shehu SH.P.K., kam dyshime se nënshkrimi dhe/ose dokumentacioni im mund të jenë përdorur pa autorizimin dhe pëlqimin tim. Këtë çështje e bëj të ditur për transparencë dhe për dijeninë tuaj, pa paragjykuar konstatimin e organeve kompetente.

Kjo shkresë lëshohet me qëllim të informimit të kompanisë Valdrini SH.P.K. dhe të evidentimit të qëndrimit tim lidhur me marrëveshjen e bashkëpunimit për projektin në fjalë.

Me respekt,

Vehbi Goxhuli

Inxhinier i Mjedisit
Nënshkrimi: Vehbi Goxhuli

Nr. kontaktues: +38349380301

Lënda: Kërkesë për konfirmim të operatorit ekonomik me të cilin keni lidhur marrëveshje bashkëpunimi si inxhinier i mbrojtjes se mjedisit për aktivitetin e prokurimit me titull **"Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra"-projekt dy vjeqar"**, me numër të prokurimit 612-26-8159-5-1-1, Komuna Fushë Kosovë.

I nderuar z. Vehbi Goxhuli, Gjatë vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra"-projekt dy vjeqar, me numër të prokurimit 612-26-8159-5-1-1, kemi konstatuar se emri juaj si inxhinier i mbrojtjes se mjedisit eshte ne nje marrëveshje bashkëpunimi dhe dokumentet tuaja si ing mjedisi(Diploma,CV,referencat,Licensat) figurojnë në dokumentacionin e ofertës së operatorit ekonomik V-Shehu Sh.p.k., si dhe në dokumentacionin e ofertës së operatorëve ekonomikë Goe: Valdrini Sh.p.k. & NNP Ndertimi.

Për këtë arsye, kërkojmë nga ju që të na konfirmoni qartë se : Me cilin nga këta operatorë ekonomikë keni lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e projektit "Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra" -projekt dy vjeqar, me numër të prokurimit 612-26-8159-5-1-1: Me OE: V-Shehu Sh.p.k. apo me GOE: Valdrini Sh.p.k. & NNP Ndertimi?

Ju lutemi të specifikoni saktësisht emrin e operatorit ekonomik me të cilin keni marrëveshje për këtë projekt dhe të konfirmoni nëse kjo marrëveshje është valide dhe në fuqi. Përgjigjen tuaj kërkojmë ta përcillni me shkrim në këtë adresë elektronike, në mënyrë që autoriteti kontraktues të ketë sqarimin e nevojshëm gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.

Faleminderit për bashkëpunimin.

Me respekt,

Nexhat Bajqinca

Zyrtar i Lartë për Makineri

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis

Komuna e Fushë-Kosovës

Mob: 044/ 402-393

Tel: 038/200 40536

VoIP: 40536

E-mail:nexhat.bajqinca@rks-gov.net

All folders | From: Vehbi Goxhuli

File Home View Help Search

Has attachments | Unread | Mentions me | Flagged | High importance | To me | Highlight | Close search

Valdrini.shpk@hotmail.com

- Inbox 7
- Junk Email [2]
- Drafts [3]
- Deleted Items 76
- Sent Items
- Archive
- Conversation History
- Notes
- Search Folders

Go to Groups

Kërkesë

IP

Ismete Prebreza

To: Vehbi Goxhuli; vehbigoxhuli@gmail.com; valdrini.shpk@hotmail.com

Cc: Nexhat Bajqinca

Thu 11/19/2026 8:59 AM

Pergjigja e AK-se (11).pdf
1 MB

Pershendetje,
Bashkangjitur keni pergjigjen nga Autoriteti Kontraktues

Me respekt,

Ismete Prebreza
Zyrtare e Prokurimi
Komuna e Fushë Kosovës
Tel. 038/ 200 40 512
VOIP: 40512
e-mail: ismete.prebreza@rks-gov.net

From: Vehbi Goxhuli <vehbigoxhuli@yahoo.com>
Sent: Wednesday, November 18, 2026 3:51 PM
To: vehbigoxhuli@gmail.com; valdrini.shpk@hotmail.com
Cc: Nexhat Bajqinca <Nexhat.Bajqinca@rks-gov.net>; Ismete Prebreza <Ismete.Prebreza@rks-gov.net>
Subject: Re: Kërkesë

...

Reply | Reply all | Forward

V-SHEHU SH.P.K.
Adresa: 51 050 Junik, Kosovë
Telefon: +383 44 544 009
E-mail: vshehu.ks@gmail.com

Data:02.11.2026

Në përputhje me nenin 10 paragrafi 2, pika 2.1, dhe nenin 11 paragrafi 1, të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt.01.12.2010,

Punëdhënësi dhe Punëmarrësi, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin këtë:

PARAKONTRATË

Me këtë Parakontratë:

1. Punëdhënësi: **"V-SHEHU"SH.P.K., Junik,** me numër Identifiukes **810146739,** me seli në **Junik,** të cilin e përfaqëson drejtor z.**Arsim Shehu** i lindur me dt: **20.02.1985** në Junik me nr ID: **1171574427**.

2. Punëmarrësi - . lindur me dt: në Makërmal, me profesion: **Inxhinieri e mbrojtjes së mjedisit – Mbrojtje te ambientit**

Përcaktojnë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë për krijimin e marrëdhënieve kontraktuale të punës.

Neni 1

1.1 Punëmarrësi do të kryej punët si: **Inxhinier i mbrojtjes së mjedisit.**

1.2 Punëmarrësi bën udheheqjen dhe ekzekutimin e projektit në fjalë, dhe detyrime të tjera që rrjedhin nga kjo marrëdhënie e punës.

Neni 2

2.1 Për projektine dhënë nga: **Kuvendi Komunal Fushë Kosovë.**

2.2 Titulli i projektit: **Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra -projekt dy vjeçar.**

me nr prokurimit: **612-26-8159-5-1-1**

Neni3

3.1 Punëmarrësi është I detyruar të fillojë punën me fillimin e ekzekutimit të projektit.

3.2 Kjo Parakontratë fillon nga dita e fillimit të projektit deri në përfundimin e projektit.

3.3 Kjo Parakontratë fillon së zbatuari në momentin kur Kompania në fjalë lidh parakontraten me autoritetin kontraktues, punëdhenësin.

Neni 4

V-SHEHU SH.P.K.
Adresa: 51 050 Junik, Kosovë
Telefon: +383 44 544 009
E-mail: vshehu.ks@gmail.com

4.1 Nëse punëmarrësi nuk e fillon punën ditën e caktuar, sipas marrëveshjes më këtë parakontratë, pa e paralajmëruar punëdhënësin për arsyet e mos fillimit të punës, do të konsiderohet se me vullnetin e vet, e ka shkëputur këtë parakontratë në mënyrë të njëanshme.

4.2 Secila palë mund ta shkëpusë këtë parakontratë në mënyrë të njëanshme, sipas kushteve dhe rasteve të caktuara me Ligj dhe me parakontratë Kolektive. Punëdhënësi dhe i punësuari, mund ta ndërpresin mardhënien e punës me njoftim paraprak prej tridhjet (30) ditësh.

Neni 5

5.1 Punëmarrësi, në punë dhe detyra të përcaktuara sipas nenit 1 të kësaj parakontrate, do të angazhohet prej momentit kur fillon ekzekutimi i projektit.

Neni 6

6.1 Orari i punës është 40 orë pune në javë, nëse Punëdhënësi dhe Punëmarrësi nuk merren vesh ndryshe. Pushimi gjatë ditës së punës, caktohet sipas marrëveshjes në mes të punëdhënësit dhe të punëmarrësit, varësisht nga koha e kaluar në punë.

6.2 Punëdhënësi mund ta ndryshojë orarin gjatë ditës, sipas nevojës së paraqitur në procesin e punës.

Neni 7

7.1 Të punësuarës i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen dhe i pranohet nga punëdhënësi në lartësi prej: ' ' . . , euro Neto për pune për angazhim të Punëmarrësit sipas nenit 3 të kësaj Kontrate.

7.2 Pagesa bëhet çdo muaj, për muajin paraprak, përmes xhirollogarisë së Punëmarrësit, tek banka e autorizuar, apo në afate më të shkurtra kohore, sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese.

Neni 8

8.1 Punëmarrësja, për angazhim në punët sipas nenit 32.paragrafi.1.1Ligjit të Punës Nr.03/L-212 i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtate tjera të përcaktuara në parakontratën Kolektive dhe parakontratën e Punës.

Neni 9

9.1 Punëdhënësi obligohet që gjatë kryerjes së detyrave të punës, të sigurojë për Punëmarrësin mjetet dhe masat e mbrojtjes në punë, sipas dispozitave të përcaktuara me Ligj, parakontratë Kolektive dhe me akte të tjera nënligjore.

Neni 10

10.1 Punëmarrësi është i detyruar sipas dispozitave ligjore, t'iu përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

V-SHEHU SH.P.K.
Adresa: 51 050 Junik, Kosovë
Telefon: +383 44 544 009
E-mail: vshehu.ks@gmail.com

Neni 11

11.1 Punëmarrësi pajtohet që gjatë gjithë procesit të punës, mund të caktohet të punojë edhe në ndonjë detyrë tjetër të punës, sipas nevojave të Punëdhënësit dhe kushteve të përcaktuara me Ligj, parakontratë Kolektive apo me parakontratë të Punës.

Neni 12

12.1 Punëdhënësi dhe Punëmarrësja me vullnet të dyanshëm i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me Ligj, me parakontratë Kolektive dhe me këtë parakontratë.

Neni 13

13.1 Palët kontraktuese mund të arrijnë marrëveshje edhe për të drejta dhe detyrime të veçanta, të cilat nuk janë në kundërshtim me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore të aplikueshme.

Neni 14

14.1 Për mosmarrëveshjet eventuale, lidhur me zbatimin e kësaj Parakontrate Pune, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Themelore në Pejë.

Neni 15

15.1 Pas njoftimit me përmbajtjen parakontratës, kjo Parakontratë u nënshkrua nga palët kontraktuese, në zyren në Junik, në 2 kopje autentike, nga të cilat, secilës palë i mbeten nga një kopje.

Punëdhënësi:

Drejtor z.Arsim Shehu

SH.P.K. V-SHEHU NUI: 810146739 JUNIK-KOSOVË

I Punësuari:

REPUBLIKA E KOSOVËS
UNIVERSITETI I PRISHTINËS

REPUBLIC OF KOSOVO
UNIVERSITY OF PRISHTINA

DUBLIKATE
Nr. prot.
Dt. lëshimit:

FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE DHE TEKNOLOGJISË NË MITROVICË

FACULTY OF GEOSCIENCES AND TECHNOLOGY IN MITROVICË

Diplomë Diploma

U regjistrua në vitin akademik 2000/2001 në studimet master.

Was enrolled in the academic year 2000/2001 in master studies.

Studimet i mbaroi më 31 mars 2007.

Completed his/her studies on 31 March 2007.

E mbrojti me sukses temën e magjistraturës:

Defended his/her Magister thesis:

Përcaktimi i ndikimit të deponive të hirit nga TC Kosova A në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Determining the impact of ash dumps from TC Kosova A on surface and underground water pollution

INXHINIERI E MBROJTJES SË MJEDISIT

ENVIRONMENTAL PROTECTION ENGINEERING

Titulli i fituar:
MAGJISTËR I SHKENCAVE TEKNIKE

Obtained the title:
MASTER OF TECHNICAL SCIENCES

Niveli i kualifikimit sipas **Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 7**

Level of qualification according to the **National Qualifications Framework: 7**

Prishtinë, 9 tetor 2024

Prishtina, 9 October 2024

Nr.61

Dekani / Dean
Prof. Asoc. Dr. Festim Kutllovci

Rektori / Rector
Prof. Dr. Arben Hajrullahu

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planing and Infrstructure

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI lëshon:

Nr. i licencës: 25/19/24

LICENCË

Mr.sc.inxh.dipl.i shk.teknike

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM– së

Data e vlefshmërisë:
12.08.2024— 11.08.2029
Prishtinë

z. Liburn Aliu
Ministër i MMPHI

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Inženjerska komora Republike Kosova
Chamber of Engineers of The Republic of Kosovo

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenet 5,7,8,9 dhe 11 të Rregullores për Procedurën e Licencimit, Rilicencimit, Mirëmbajtjen, Pezullimin dhe Revokimin e Licencës së Inxhinierit të Licencuar të Odës me numër protokoli 8651/24 të datës 31.12.2024 dhe bazuar në Vendimin e Komisionit Vlerësues me numër 619/2025 të datës 22.07.2025, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, lëshon:

LICENCA A

INXHINIER I LICENCUAR



Titulli akademik: Maxhistër I Shkencave Teknike
Drejtimi: Inxhinieri e Mbrojtjes së Mjedisit

Data e lindjes: 02.10.1966

Numri i licencës: M-0223

Data e lëshimit:
22.07.2025

Data e skadimit:
22.07.2030

Kryetar i Odës
Arsim RAPUCA



Prishtinë



	Viti i studimeve Institucioni-(Universiteti i Prishtinës në Kosovë: Diploma -I nga Fakulteti Xehetaro Mineralo-Metalurgjik, drejtimi : Gjeologji e Përgjithësme) Fakulteti Xehetaro -Metalurgjik, Gjeologji, gjatë: [redacted] Titulli: Kualifikim superior - Inxhinier i diplomuar për gjeologji .Pastaj sipas sistemit të Bolonjës pas vitit 2000 barasvlersohet emërtohet master në Gjeoshkenca e Aplikuar e Mjedisit Engxh.dipl.Ms. Gjeologji e përgjithshme Kualifikimi superior - Inxhinier i diplomuar për gjeologji & **inxh.dipl.gjeologji 1986 - 1992**; Diploma I (dhjetë-10 semestra). **Diploma-II Viti i studimeve të pasuniversitare: UP-** Fakulteti i Teknologjive industriale në Mitrovicë. Departamenti i teknologjisë Drejtimi: **" Inxhinieria Mbrojtejes së Mjedisit " ,** gjatë: 2003-2007, me titullin: **Mr.inxh.dipl.** [redacted] **Magjister i Shkencave Teknike.**
Numri Personal në ID	[redacted]
Adresa	: [redacted]
nr.telefon : +383	[redacted]
e-mail :	[redacted] & [redacted]
Institucioni shkollor : Gjimnazi natyrore teknik Data-gjatë: 1981- 1985	**Gjimnazi në këtë periudhë emërtohej " Silvira Tomazini " në** Mitrovicë dhe në **Zveçan**
Profesioni: Nga Institucioni-Universitar **Diplomë(I): Viti i studimeve 1986 deri në 1992**	**(Universiteti i Prishtinës në Kosovë, tani Universiteti Publik " Hasan Prishtina": Fakulteti Xehetaro-Metalurgjik, drejtimi:Gjeologji Fakulteti i Gjeoshkencave , gjatë: 1986-1992. Titulli: Kualifikim superior -Inxhinier i diplomuar për gjeologji. Kurse barasvlersimi sipas sistemit të Bolonjës pas vitit 2000 emërtohet Gjeoshkenca e zbatuar të Mjedisit Titulli:Master .Ms. Gjeologji e përgjithshme 1986 – 1992; dhjetë-10 semestra**

45.Elaboratet për mbrojtje nga zjarri për objektin Gastronike dhe salla e dasmeve ne zonën Kadastrale Gremnik Lokacioni Zajm në Komunën e Klinës, Salla e dasmave Gezimi Imperial

45. Elaborati për Mbrojtjen nga zjarri Për Auto sallonin e Automjeteve Komunë e Shtimës

46. Elaborati për mbrojtjen nga zjarri për Stacionin e Karburanteve Pompa e Benzinës " Nebi Petrol " Lokacion Pemishte në Komunën e Istogut.

47. Menaxhimi i resurseve ujore në pellgun e Moravës së Binçës , investior skat (Zvicra dhe Austria) .Menaxhimi e i pellgut Lumore ë të Morava Baseni e udhëhequr nga Mr.sc.inxh.dipl. Vehbi Goxhuli përfaqësues i OJQ Gjkeomjedisi në koordinim me skat Kosova..

48. Monitorimi i debateve publike për Resurset Ujore dhe Pellgjet Lumore nga Mr.inxh.dipl. Vehbi Goxhuli .

49. Raporti i VNM-së për ndërtimin e Deponis për izolimin dhe asgjësimin e asbestit në zonën e KEK-ut. Vehbi Goxhuli e ka relizue në kuadër te Kompanis N.SH. Gjeomjedisi

50. Elaborati i Gjeomekanikës për ndërtimin r Deponis për të ndërtimi e të landfilli Deponi Sanitare për të heqjen dhe asgjësimin izolimin e azbesti në zonën e KEK-ut në Lokacionin Dardhishtë Zona e KEK-ut..

51. Gjeomekanike analizat dhe gjeomekanike shtjellimi për i gjatë ndërtesat në të zonë të Ferizajt dhe të Shtimes.

52. Elaborat për mbrojtjen e mjedisit në zonën komerciale në Lipjan,

53. Elaborat për mbrojtje nga zjarri nga [illegible] në zonën ekonomike Konjuh në Lipjan për depon për biznesin objekti investuar nga Bahriu Deva, Dipl. Ing., dhe Afërdita Deva Arkitekt përmes Kompania Piccolo Ltd.

54. Hartimi i planit të sigurisë dhe përgatitjes për punë ndërtimore, duke përfshirë edhe sinjalizimin si dhe Organizimi i cend punishtës në aspektin e mbrojtëjes dhe siguris në punë dhe dinamika e realizimit te punëve ,parandalimi masat për të sigurinë e Objekti , duke ruajtur shëndetin e punëtorëve që fillimisht kanë akses në objektin e ndërtimit.

55. RAPORT MBI VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS - (VNM), PËR PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË TRASES RRUGËS LOKALE ME GJATESI 2000X5 m, NË: SHTUPEQ I MADH - NË GRYKËN E RUGOVËS ; LOKACIONI -, SHTUPEQ I MADH ZONA KADASTRALE SHTUPEQ I MADH .

56. RAPORTI I VNM PËR INSTALIMIN E SISTEMIT FOTOVOLTAIK NË ZONËN KADASTRALE KODRA E HUTIT NË LOKACIONIN MADANAJ VLERËSIMI NDIKIMI MJEDISORE - (VNM) PËR: ZHVILLIMI I PROJEKTIT - SISTEMI DIELLOR ME PAJISJE FOTOVOLTAIK PËR PRODHIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË RITËRITUESHME ME KAPACITË ~14.53 MVVh INVESTUES SOLAR'S GJAKOVA L.L.C.

57. RAPORTI VNM PER LEJE MJEDISORE KOMUNALE - LMK, PER NDERTIM OBJEKTIT PËR BIZNES OBJEKTI: AUTOLARJE PËR THE KOMPANIA, "H_2O AUTO VVASH" SH.PK.

ANEKS 7 Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit
(duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontrate)
(Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë)

NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit te kontratës	Data e përfundimit te kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Nurmi i telefonit te Blerësit
1	*Mbulimi I gypave DN 250mm që furnizojnë me ujë të pijes 34 fshatrat e Rekës së keqe afër kaptazhës*	*25.10.2021*	*10.03.2023*	*14,493.50€*	*Kompanija Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A*	*prokurimi@kru-gjakova.com*	*049 732 866*
2	*"Engineering, Supply of Goods and Construction Works For the Rehabilitation and Extension of District Heating networks (pipes and accessories) for District Heating (DH) Gjakova, Kosovo"*	*21.12.2021*	*11.09.2022*	*325,648.00€*	*ALL ZONE*	*info@allzone-ks.com*	/
3	*Ndërtimi I kanaleve te ujitjes*	*26.04.2022*	*08.09.2022*	*19,999.10€*	*Komuna e Junikut*	*prokurimi-junik@rks-gov.net*	*0390-370-616*
4	*Shtimi I kapaciteteve te ujit dhe rregullimi I rrjetit te ujesjellsit ne fshatin Gorancë*	*04.11.2022*	*08.12.2023*	*34,500.00€*	*Komuna Hani I Elezit*	*prokurimi.he@gmail.com*	*038 200 46-561*
5	*Ndërtimi dhe instalimi e pjesëve së Ujësjellësit, në Impiantin e Ujërave të zeza*	*01.08.2022*	*15.10.2023*	*140,030.49€*	*Kosova Water Energy*	/	/
6	*Ndërtimi I kanaleve te ujitjes – Punë Shtesë*	*23.11.2022*	*01.12.2022*	*1,940.75€*	*Komuna e Junikut*	*prokurimi-junik@rks-gov.net*	*0390-370-616*
7	*Ritender Kyçjet shtëpiake dhe rehabilitim I rrjetit të Ujësjellësit- Fshati Peqan*	*16.12.2022*	*30.12.2022*	*11,857.50€*	*KRU Hidroregjioni Jugor SH.A. Prizren*	*prokurimi@hotmail.com*	*44/191-253*

8	*Ndertimi I Kanaleve ne fshatrat e Komunes se Pejes, LOT 3 – Ndertimi I kanalit per ujitjen e siperfaqeve bujqesore ne fshatin Graboc*	*21.12.2022*	*16.12.2023*	*37,482.27€*	*Komuna e Pejes*	*Milot.r.gashi@rks-gov.net*	*038 200 43405*
9	*Ndërtimi I urës që lidhë Komunën e Junikut me Eko fshatrat Gjocaj dhe Jasiq*	*19.05.2023*	*30.11.2023*	*121,319.00€*	*Komuna e Junikut*	*prokurimi-junik@rks-gov.net*	*0390-370-616*
10	*Ndërtimi I kanalve te ujitjes ne siperfaqe bujqesore pjesa 3 LOT 1- Ndertimi I kanalit te ujitjes ne fshatin Lugaxhi*	*26.05.2023*	*27.12.2023*	*70,058.10€*	*Komuna e Pejes*	*Milot.r.gashi@rks-gov.net*	*038 200 43405*
11	*Ndërtimi I kanaleve të ujitjes (Topilla – Gaxherr)*	*26.06.2023*	*26.09.2023*	*19,860.00€*	*Komuna e Junikut*	*prokurimi-junik@rks-gov.net*	*0390-370-616*
12	*Ndërtimi I ures dhe kanalet e ujitjes te demtuara gjat vershimeve ne Komunen e Pejes.* *LOT 4 – Ndërtimi I argjenturave te pendat ne fshatrat Vranoc, Zahaq, Gllaviqic, Kotradiq dhe Buqan*	*03.07.2023*	*12.11.2023*	*56,325.00€*	*Komuna e Pejes*	*Milot.r.gashi@rks-gov.net*	*038 200 43405*
13	*Ndërtimi kanalizimit sekondar për ujërat e zeza lokacioni Bajraktar, 7 Shtator dhe Qendër(Rregullimi kanalizimit të lagjes Gaxherr, Miroc dhe Qender)*	*17.07.2023*	*20.10.2023*	*43,375.00€*	*Komuna e Junikut*	*prokurimi-junik@rks-gov.net*	*0390-370-616*
14	*Ndërtimi I mureve mbrojtëse, lokacioni Tofaj dhe Pepsh*	*01.09.2023*	*20.12.2023*	*18,019.75€*	*Komuna e Junikut*	*prokurimi-junik@rks-gov.net*	*0390-370-616*

15	*Hapja, ndertimi dhe sanimi I kanalit vershues prej shkolles "Xhemajl Kada"(Furra Husaj) deri te kanali atmosferik Fidanishte dhe Dulia*	*12.09.2023*		*249,240.10€*	*Komuna e Pejes*	*Milot.r.gashi@rks-gov.net*	*038 200 43405*
16	*Ndërrimi I gypave te rrjetit ujësjellësit nga AC në PE, nga Emin Duraku deri ne fshatin Osek Hyle*	*17.11.2023*	*08.05.2024*	*326,575.74€*	*Kompanija Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A*	*prokurimi@kru-gjakova.com*	*049/732- 866*
17	*Ndërtimi I urës që lidh Komunën e Junikut me Eko fshatrat Gjocaj dhe Jasiq – Punë Shesë*	*17.01.2024*	*09.02.2024*	*6,207.00 €*	*Komuna e Junikut*	*prokurimi-junik@rks-gov.net*	*0390-370-616*
18	*Ndërrimi I gypave te rrjetit ujësjellësit nga AC në PE, nga Emin Duraku deri ne fshatin Osek Hyle – PUNE SHTESE*	*25.04.2024*	*08.05.2024*	*15,033.80 €*	*Kompanija Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A*	*prokurimi@kru-gjakova.com*	*049/732- 866*
19	*Mirëmbajtja e Kanalzimit Sekondar në Lagjen Kallavaj*	*07.10.2024*	*05.11.2024*	*983.00 €*	*Komuna e Junikut*	*prokurimi-junik@rks-gov.net*	*0390-370-616*
20	*Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit 632-24-8521-5-1-1 - Rehabilitimi I rrjetit të ujsjellësit*	*09.04.2025*	*01.05.2026*	*285,000.00 €*	*Lika Trade shpk*	*likatrade@hotmail.com*	+383 179 343
21	*LOT 1 Asfaltimi i rrugcs KEOR AKI - Zagerm Komuna e Pejes- Punimi I kanalizimit Fekal*	*25.08.2025*	*01.05.2026*	*42,000.00 €*	*Lika Trade shpk*	*likatrade@hotmail.com*	+383 179 343
22	*Ndërtimi I ujësjellësit për fshatrat e Lugut te Baranit-Ritender*	*14.03.2023*		*1.377.859,71 €*	*Komuna e Pejes*	*Milot.r.gashi@rks-gov.net*	

(Shto/fshij sipas nevojës)

Bashkëngjit: certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Ankes dhe nëse vertetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë te Operatoreve Ekonomik.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik

Vula



V-SHEHU SH.P.K.

Adresa: 51 050 Junik, Kosovë
Telefon: +383 44 544 009
E-mail: vshehu.ks@gmail.com

LISTA E PUNËTORËVE

Nr.	Emri dhe mbiemri	Profesioni / Pozita	Pozicioni	Përvoja e punës
1		Puntor		15 vite
2		Puntor		5 vite
3		Puntor		10 vite
4		Puntor		
5		Puntor		12 vite
6		Puntor		10 vite
7		Puntor		20 vite
8		Puntor		10 vite
9		Puntor		7 vite
10		Punor		15 vite
11		Puntor		10 vite
12		Puntor		8 vite
13		Puntor		10 vite
14		Puntor		15 vite
15		Puntor		15 vite
16		I qertifikuar per punime ne kanalizim	Puntor I qertifikuar	15 vite
17		I qertifikuar per drenazhim te dheut	Puntor I qertifikuar	20 vite
18		I trajnuar per perdorim dhe manovrim te mjeteve	Puntor I trajnuar	8 vite
19		I qertifikuar per Siguri dhe Shendet ne vendin e punes dhe mbrojtjes nga zjarri	Puntor I qertifikuar	20 vite

MARRËVESHJE FURNIZIMI

Lidhur ne mes te:
"Karakushi sh.p.k" me numër unik identifikues: **811125716**, të cilin e përfaqëson drejtor **z.Mehmet Karakushi** &

"V-SHEHU"SH.P.K, me sclinë në **Junik**, me numër unik identifikues: **810146739**, të cilin e përfaqëson, drejtori z. **Arsim Shehu.**

OBJEKTIVI I KËSAJ MARRVESHJE ËSHTË:

Neni 1

Palët në fjalë merren vesh si në vijim **Karakushi sh.p.k** me numër unik identifikues: **811125716**, të cilin e përfaqëson drejtor **z.Mehmet Karakushi** me nr të Licensës per shfrytezim **1166/KPMM/2012 leshuar nga komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale** , arrijne marreveshje qe te furnizoj kompanin **"V-SHEHU"SH.P.K** me sclinë në **Junik**, me numër unik identifikues: **810146739**, të cilin e përfaqëson, drejtor z. **Arsim Shehu,** të bëjë furnizimin , te llojeve te ndryshme deri në përfundimin e projckitit tc shpallur nga:
KUVENDI KOMUNAL FUSHE KOSOVE me titull:

Ndërtimi i kanalizimeve fekale ne Fushe Kosove dhe fshatra- projekt dy vjeçar

Nr i prokurimit	612-26-8159-5-1-1
Nr i brendshëm	612 26 057 511

Neni 2

Kompanija **"Karakushi sh.p.k"** obligohet që ndaj, **"V-SHEHU"SH.P.K** që për punët e kryera me furnizim t'i kryej me kohë pagesat, dhe atë gjithmonë në të njëjtën datë kur të bëhet pagesa e situacionit të punimeve.

Kjo marrveshje u hartua dhe u nënshkrua me vullnetin e lirë dhe të plotc të palëve.

PALËT KONTRAKTUESE

"Karakushi sh.p.k"
Drejtor z.**Mehmet Karakushi**

"V-SHEHU"SH.P.K
Drejtor z.Arsim **SHEHU**

Data: 22.10.2026

GOE : "VALDRINI" SHPK & NNP NDERTIMI

PËR: ZPP – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË

KËRKESË E PËRSËRITUR PËR QASJE NË DOKUMENTACIONIN E OFERTUESIT TE REKOMANDUAR PER FITUES , NË TENDERIN:

Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar 612-26-8159-5-1-1

Grupi i operatorëve ekonomik: **Valdrini shpk & NNP Ndertimi** me datë 16/11/2026 ka bërë kërkesë zyrtare (konform Nenit 10 pika 3 të LPP-së) për qasje në dokumentacionin e tenderit për ofertuesin e rekomanduar per fitues V-SHEHU Sh.p.k. Qasja na është dhënë pjesërisht vetëm për dy apo tri dokumenta duke përfshirë edhe anekset Nr. 3, por JO edhe për dokumentacionin e kërkuar konform nenit 68 dhe 69 të LPP-së , si : Lista e stafit teknik dhe professional,deshmite e stafit teknik dhe professional,marrveshjet me stafin teknik dhe professional deshmite e tyre si diplomat,cv,referencat,licensat etj ,Lista e Paisjeve ,marrveshjet me OE per paisje me qera deshmite e paisjeve si dudi doganor,fatura ose libreza, etj.Arsyetimi për mos dhënie ka qenë se gjoja OE : V-SHEHU Sh.p.k e ka plotësuar Aneksin Nr. 3 për sekret afarist dhe të dorëzuar me ofertë.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në mosdhënien e qasjes në dokumentacionin e kërkuar ka bërë shkelje të Nenit 11 pika 4 të LPP-së dhe Nenit 7 të Rregullores për Prokurim Publik si dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare, duke na përjashtuar nga e një e drejtë e garantuar me LIGJ. Janë shkelë nenet:

Neni 7.6.2 Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave dhe para publikimit të B58 "Njoftimi mbi vendimin e AK-së", duhet të përgatitë versionin e pastruar në përputhje me paragrafin 4 të nenit 11 të LPP-së dhe të njoftojë palën.

Neni 7.6.3 Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Neni 7.6.5 Jo të gjitha dokumentet e specifikuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë në përputhje me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, mund të klasifikohen si informata sekrete afariste. Dokumentet e specifikuara sipas nenit 68 e 69 të LPP e të cilat janë publike në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit tjetër përkatës në fuqi, nuk mund të klasifikohen si informata sekrete afariste.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ka keqpërdorë detyrën zyrtare ose pa vetëdije që nuk e dinë çka është spastrim i dokumentacionit, ose përfitues ose i shantazhuar nga bizneset apo palët e treta. **Fillojmë me radhë:**

1. Si mund të pranohet nga ZPP sekret afarist dokumentacioni konform Nenit 68, psh. Deklaratat tatimore, kur ato janë publike apo Deklarata nga Banka për financim.

2. Si mund të pranohet nga ZPP sekret afarist dokumentacioni konform Nenit 69, Lista e kontratave, referencave, raporteve të pranimeve përfundimtare etj.

3. Si mund të pranohet nga ZPP sekret afarist Lista e punëtorëve, inxhinerëve, kontratat, diplomat, CV-it etj.

4. Si mund të pranohet nga ZPP sekret afarist Lista e pajisjeve, siq janë DUD-i, Faturat, Libreza e qarkullimit etj.

5. Si mund të pranohen nga ZPP sekret afarist paramasa dhe parallogaria.

6. Si mund të pranohen nga ZPP arsyetimi i OE si sekret afarist për dokumentacionin e lartëcekur konform Nenit 68 dhe 69 se gjoja të mos ju ipen publikut dhe palëve të treta se dëmtohemi si biznes në aspektin material.

Po ua përkujtojmë ZPP se Ne nuk jemi as publik dhe as palë e tretë, por jemi **palë e interesit** deri sa të përfundoj ky projekt dhe të pranohet teknikisht duke përfshirë edhe kohën në eliminimin e defekteve edhe pas pranimit teknik.

Zyrtari i Prokurimit po shihet se nuk ka vepruar konform përgjegjësisë që e ka si Zyrtar përgjegjës sepse as që është munduar ta kryej detyrën e vet zyrtare konformë Ligjit në pastrimin e dokumentacionit.

Po shihet se ZPP është larg me njohjen e Ligjit të prokurimit në këtë drejtim, vetë fakti se ka ra nën ndikimin e një kërkese absurde dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi, pra ZPP po ua përkujtojmë:

a) Sekret afarist sipas Nenit 68 trajtohen vetëm transaksionet bankare të përditshme që ndodhin në mes të Biznesit dhe palëve në lëminë e biznesit.

b) Sekret afarist sipas Nenit 69 nuk trajtohet Lista e referencave, kontratave, raportet e pranimeve, pagesa përmes bankave e këtyre punëve, faturat e lëshuara etj, sepse ato janë publike dhe të raportuara edhe në ATK.

c) Sekret afarist sipas Nenit 69 nuk trajtohet Lista e stafit përgjegjës teknik, as diplomat, as CV-it, as parakontratat. Prandaj roli i ZPP është t'a pastroj dokumentacionin, si psh. Te kontratat ta hjekë numrin personal dhe pagën e

përcaktuar dhe asgjë ma shumë, te CV-ija t'i hjekë të dhënat personale, por Jo përvojën, shkollimin, dhe çfardo të dhëne tjetër që është e rëndësishme për Ne.

d) Sekret afarist sipas Nenit 69 nuk trajtohet Lista e pajisjeve, aq më pak, DUD-i, faturat, libreza e qarkullimit etj dhe

e) Sekret afarist nuk trajtohet paramasa dhe parallogaria, kjo është absurde dhe keqpërdoruese.

Ju lutemi si mund ta përgadisim një Ankesë kur na keni përjashtuar nga e drejta e jonë ligjore në qasjen e dokumentacionit tenderik. Poashtu Ju pyesim a keni lexuar ankesë ndonjëherë, pra pikat e ankimimit të ofertuesve të pa kënaqur, ku e cekin, se në bazë të qasjes në dokumentacion, filan inxhineri nuk e ka përvojën e ofruar ashtu si është kërkuar, nuk e ka pajisjen ashtu si është kërkuar, nuk e ka përvojën e kërkuar në bazë referenacave të ofruara, ka çmime jo-normalisht të ulëta apo manipuluese. Pra ankesa përgaditet në bazë të dokumentacionit të pranuar nga qasja e kërkuar dhe të lejuar.

Përfundimisht **NE KËRKOJMË** që menjëherë të kryhet pastrimi i dokumentacionit dhe përmes emailit ose te vijme fizikisht me CD, të na dërgohet dokumentacioni i kërkuar **JO më vonë se ora 11:00 e datës 18 nëntor 2026**, ne email: valdrini.shpk@hotmail.com Përndryshe Ne do ta kërkojmë qasje në dokumentacionin e kërkuar përmes avokatit që do ta angazhojmë dhe prap nuk do të marrim dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të lejuar, **citojmë: Neni 7.6.3 të RRPP, në bazë të një kërkese nga pala e interesit, ZP ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal,** në të kundërten Ne do të ngrisim **PADI ndaj ZPP** për mos respektim të Ligjit, keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe përjashtimin nga e drejta e jonë ligjore që ta kemi dokumentacionin e kërkuar.

DATA: 17/11/2026

"VALDRINI" SHPK

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR VALDRINI Gllogoc

Outlook

Kërkesë

From Valdrini ShPK <valdrini.shpk@hotmail.com>
Date Fri 11/20/2026 11:39 AM
To Kk Fushe kosove Prokurimi <ismete.prebreza@rks-gov.net>

Pershendetje!

Kerkese per dokumentet e pa derguara per projektin : Ndertimi i kanalizimeve fekale ne Fushe Kosohe dhe fshatra-projekt dyvjeqar

Kemi pranuar disa dokumente shtese nga ju , por nuk na keni derguar edhe deshmite e paisjeve dhe marrveshjet me operatore ekonomik per paisje si dhe sqarimet e kerkuar nga ju tek OE ,per OE te shpallur fitues V-Shehu shpk. Andaj kerkojme nga ju qe te na dergoni edhe keto kerkesa ne menyre qe te kemi te kjarte te gjithe procesin dhe oferten e tij.
Kohen e kemi te limituar andaj kerkojme nga ju te na dergoni sa me shpejte qe mundeni ne emailin : valdrini.shpk@hotmail.com

Me respekt!
Valdrini Shpk
Drenas

Get Outlook for iOS

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues : Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar

Nr. i brendshëm: 612-26-8159-5-1-1

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1	VB HOLDING SH.P.K.	**659 765.40 €**
2	Grup i Operatorëve Ekonomik Valdrini sh.p.k; N.N.P. Ndertimi	**649 983.20 €**
3	" V - SHEHU " SH.P.K.	**599 438.00 €**

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna e Fushë Kosovës **shpërblen me kontratë : " V - SHEHU " SH.P.K.** ne vlere prej **599 438.00 €**

Data: 16.11.2026

Emri dhe mbiemri i ZPP: Ismete Prebreza

Prebreza

Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[1]

KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË, Objekti i ri i Komunës, rr. "Tahir Zemaj" nr.2 (afër QKMF-së) 12000 Fushë Kosovë

" V - SHEHU " SH.P.K.

i Prokurimit	612-26-8159-5-1-1
Nr i brendshëm	612 26 057 511

Titulli: Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar

I/e nderuar(a) *[Z/Znj]*

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar *tenderin me çmimin më të ulët* si përgjigje për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj prej **599 438.00 €** dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Me respekt,
Zyrtare e Prokurimit
Ismete Prebreza

[1] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*

Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm [1]

KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË, Objekti i ri i Komunës, rr. "Tahir Zemaj" nr.2 (afër QKMF-së) 12 000 FUSHË KOSOVË

Grup i Operatorëve Ekonomik Valdrini sh.p.k; N.N.P. Ndertimi

Nr. i prokurimit:	612-26-8159-5-1-1
Nr i brendshëm	612 26 057 511

Titulli: Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar

I/e nderuar(a) *[Z/Znj]]*

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj *nuk qe tenderi me çmimin më të ulët* në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë OE **" V - SHEHU " SH.P.K.** për një shumë prej **599 438.00 €**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Njoftimi i dhënies së kontratës është i publikuar ne platformën elektronike.

Me respekt,

Ismete Prebreza, Prebreza

[Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit] *[Nënshkrimi]*

---

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve që i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues, të paraqitura në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit, por të cilëve nuk u është dhënë kontrata, ngase tenderët e tyre nuk qenë nga më të mirët sipas kriterit për dhënien e kontratës.*

Letër standarde për *[tenderuesin] [kandidatin]* e eliminuar [1]

KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË, Objekti i ri i Komunës, rr. "Tahir Zemaj" nr.2 (afër QKMF-së) 12 000 FUSHË KOSOVË

VB HOLDING SH.P.K.

Nr. i prokurimit:	612-26-8159-5-1-1
Nr i brendshëm	612 26 057 511

Titulli: Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar

I/e nderuar(a) *[Z/Znj]]*

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

[Tenderi juaj] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]* Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:

[Tenderi i juaj] është administrativisht e papërgjegjshme:

ARSYETIM

Ofertajuaj është eliminuarpër arsye se nuk keni ofruar Kerkesat e pershtateshmeris , Pershtateshmeria profesionale , Kapaciteti ekonomik financiar , Kapaciteti teknik profesional ,sigurimi i ofertës.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Ismete Prebreza, *(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)*

Prebreza *(Nënshkrimi)*

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .*

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**612-26-8159-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra-projekt dy vjeçar 612-26-8159-5-1-1**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

GOE : "VALDRINI" SH.P.K & NNP NDERTIMI
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

DRENAS
(Adresa)

DRENAS **13000**
(Vendi) *(Kodi postar)*

+38349623188 ***N/A***
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

QËNDRIM KURRUMELI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

valdrini.shpk@hotmail.com
(Adresa elektronike)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR VALDRINI Gllogoc

20/11/2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**, me date: **25.09.2026** ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: **Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar 612-26-8159-5-1-1** : si në vijim:

- Procedurë e hapur,
- Kontrate publike,
- Punë, Vlerë e madhe

Vlera e parashikuar e kontratës: **650,000.00euro**

- Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët!

Afati i fundit për dorëzim te tenderëve, ka qenë me 04.11.2026 koha 13:30,
Vendi: : **e-prokurimi.rksgov.**
Takimi për hapjen e tenderëve ka qen me datë 04.11.2026 koha 13:30,ne platformën elektronikë te prokurimit.

Me date 16.11.2026 është publikuar B58 Vendimi i Autoritetit Kontraktues per dhënie te kontrates dhe letrat standarde për tenderuesin e Papërgjegjëshëm.
Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për Letrën standarde te tenderuesit te Papërgjegjëshëm.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

Hapja e tenderit është bërë në mënyrë elektronike në vendin e caktuar dhe ne kohen e caktuar 04.11.2026 koha 13:30,Nuk kemi vërejtjeje!

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin e AK- Autoriteti kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË** dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë kërkese për rishqyrtim kundër;

- **Njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te Papërgjegjëshëm) nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit.**

- **Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës : 16.11.2026**

Për shkak të shkelje të dispozitave të;

- Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Nenin 1, Qëllimi, par 1 dhe 3.
- Nenin 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.
- Nenin 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6
- Neni 10, Qasja në dokumentacion
- Nenin 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, par 1, nen par 1.1 ; 1.2 dhe par 3.
- Nenin 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe 4
- Nenin 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1
- Nenin 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, par 1.

- Nenin 72 të LPP-së, të Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, par 1 dhe 2.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Nenin 38, Sqarimi i Tenderëve, par 38.1
- Nenin 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a; b dhe c
- Nenin 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen (d) dhe (o)

III. Dispozitat e Udhëzuesit nr. 01/2023 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi UA2) dhe atë:

- 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: **Sa i përket Formulari Letrës standarde për tenderues te ELIMINUAR.**

E kundërshtojmë në tërësi vendimin e AK lidhur me letrën standarde për tenderues te Papërgjegjëshëm, për faktin se arsyetimi i AK sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pa bazuar dhe në shkelje të kërkesave te përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT dhe në shkelje të dispozitave Ligjore të LPP-së.

Autoriteti kontraktues **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË** me date 16.11.2026 ka derguar vendimin dhe letren standarde ne te cilen ka propozuar per shperblim me kontrate operatorin ekonomik : **V-SHEHU SH.P.K** me çmimin total te ofertes : 599,438.00 €.Ak. ka bere shkelje te rregulloreve te prokurimit publik sepse OE : V-SHEHU SH.P.K i rekomanduar per kontrate është i papergjegjshem sepse nuk ka plotesuar kerkesat e AK ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate, dhe poashtu dyshojme se ka perdorur dokumente jo valide dhe pa autorizim.

Pretendimet tona lidhur me OE:V-SHEHU SH.P.K te rekomanduar per fitues janë :

1)PRETENDIMI I PARË : Operatori Ekonomik V-SHEHU Sh.p.k ne oferten e tij ka prezantuar **Marrëveshje Bashkëpunimi(parakontratë)** me Inxhinierin e Mbrojtjes së Mjedisit, **Z. Vehbi Goxhuli**, së bashku me dokumentet e tij profesionale (diploma,licensa, certifikata, CV, etj.),pa dijenine e inxhinierit z.Vehbi Goxhuli, me kete rast po paraqesim kërkesën për eliminimin e menjëhershëm të Operatorit Ekonomik **"V-Shehu shpk"** nga gara e mëtutjeshme në

procedurën e tenderimit për aktivitetin e prokurimit **Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar 612-26-8159-5-1-1**, për shkak të shkeljeve të rënda ligjore dhe prezantimit të të dhënave të rreme në ofertën e tij.

Arsyetimi i Shkeljes:

Gjatë procesit të verifikimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dorëzuar nga OE "V-Shehu shpk", është konstatuar nga komisioni vlersues se ky operator ka përfshirë në ofertën e tij një **Marrëveshje Bashkëpunimi(parakontratë)** me Inxhinierin e Mbrojtjes së Mjedisit, **Z. Vehbi Goxhuli**, së bashku me dokumentet e tij profesionale (diploma,licensa, certifikata, CV, etj.).

Pas kontaktimit dhe verifikimit të drejtpërdrejtë me email zyrtar antari i komisionit vlersues te ofertave, vetë inxhinieri **Z. Vehbi Goxhuli ka konfirmuar zyrtarisht me email se NUK ka asnjë marrëveshje bashkëpunimi** me këtë operator ekonomik(**V-SHEHU SH.P.K**). Dorëzimi i dokumenteve të tij dhe nënshkrimi i marrëveshjes është bërë tërësisht pa dijeninë, pa autorizimin dhe pa pëlqimin e tij, duke e bërë këtë marrëveshje plotësisht **të pavlefshme (jo valide)** dhe me elemente të falsifikimit.Deshmi per kete qeshtje jane: Kerkesa nga antari i komisionit vlersues per informim me email zyrtar,pergjigjia e inxhinierit Vehbi Goxhuli me email ,Deklarata e inxhinierit me email drejtuar autoritetit kontraktues dhe kompanise tone Valdrini sh.p.k. si OE pale interesi ne kete aktivitet prokurimi.

Baza Ligjore për Eleminimin e OE: V-SHEHU Sh.p.k :

Në bazë të Legjislacionit të Prokurimit Publik në fuqi, prezantimi i të dhënave të rreme, mashtrimi apo dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara/pa autorizim me qëllim plotësimin e kritereve të kapacitetit teknik dhe profesional, përbën bazë absolute për eleminim të menjëhershëm të Operatorit Ekonomik. Konkretisht:

- **OE "V-Shehu shpk" ka dështuar të dëshmojë kapacitetin e kërkuar profesional në mënyrë të ligjshme.**

- **Përdorimi pa autorizim i identitetit dhe dokumenteve të një pale të tretë cenon parimin e ndershmërisë dhe transparencës në prokurim publik.**

Kërkesa:

Mbështetur në deklaratën dhe konfirmimin e **Z. Vehbi Goxhuli,** kërkojmë nga zyra e prokurimit që të marrë vendim për **eliminimin e menjëhershëm të OE "V-Shehu shpk"** nga ky aktivitet prokurimi dhe të shqyrtohen masat e mëtutjeshme ligjore sipas rregullave në fuqi.

VEREJTJE: AK.ka dhene qasje ne keto dokumente por te njejtat i ka shlyer identitetin e inxhinierit te mbrojtjes se mjedisit Vehbi Goxhuli , dhe ka shlyer nenshkrimin e dyshuar.Pasiqe dokumentet profesionale(diploma,Cv,licensa,referenca etj) te ing Vehbi Goxhuli i kemi paraqitur edhe ne ne oferten tone atehere duke bere krahasimin korrespondon se jane te njejtat dokumente.Ne kete rast eshte e qarte se eshte perdorur ky ing. Pa autorizim dhe Pa pelqimin e tij nga OE i shpallur fitues .

2)PRETENDIMI I DYTË: Ne dosjen e tenderit kerkohet : **Kërkesa numër 1. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 975 000.00 euro. Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar te kontratave te natyres se ngjajshme. Dëshmitë për kërkesën numër 1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar numrin e prokurimit, vleren e kontrates, daten te percjella me referenca certifikata perkatese ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje.**

-OE ka ofruar nje liste te kontratave te realizuara ne tri vitet e fundit e cila nuk permban numrin e prokurimit per kontratat e realizuara respektivisht per kontratat ne institucionet publike.OE:V-SHEHU Sh.p.k nuk ka arritur te plotesoj plotesisht kete kerkese te AK ne dt Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar numrin e prokurimit.

3)PRETENDIMI I TRETË: Ne dosjen e tenderit kerkohet : Kërkesa numër 2. Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt ne pozita te ndryshme profesionale (min. 15 punetore). Dëshmitë për kërkesën numër 2.Një pasqyrë tabelare e personelit Emrin,Mbiemrin,Profesionin,Pervoja dhe **pozicioni** të angazhuar me parakontratë në kompani , duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga OE.

-OE ka ofruar nje Liste të puntoreve e cila është e paplotësuar në teresi, mungon plotesimi i pozicionit te 15 punetoreve. OE:V-SHEHU Sh.p.k nuk ka arritur te plotesoj plotesisht kete kerkese te AK ne dt.

4)PRETENDIMI I KATËRT: Ne dosjen e tenderit kerkohet: **Kërkesa numër 4. Operatori Ekonomik duhet te ketë Gurëthyes te licencuar ne pronësi apo Marrëveshje për furnizim me zhavor., Dëshmitë për kërkesën numër 4.Licenca apo leja e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale kopje , (marrveshja te jete e orgjinal dhe per kete projekt) .**

- Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik (OE: V-Shehu shpk), është konstatuar se OE ka paraqitur një marrëveshje për furnizim, mirëpo në përmbajtjen e saj nuk është specifikuar dhe definuar lloji i materialit apo produktit që do të jetë objekt i furnizimit. Duke qenë se në Dosjen e Tenderit, në mënyrë të qartë është kërkuar marrëveshje për furnizim me zhavor, dokumenti i paraqitur nga OE: V-Shehu shpk nuk dëshmon përmbushjen e këtij kriteri, pasi që nuk përmban ndonjë përcaktim konkret se marrëveshja ka të bëjë me furnizimin me zhavor.
Një marrëveshje e përgjithshme për furnizim, pa specifikimin e materialit të kërkuar, nuk mund të konsiderohet dëshmi e mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit.
Rrjedhimisht, konsiderojmë se Operatori Ekonomik V-Shehu shpk nuk ka dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar, pasi dokumentacioni i dorëzuar nuk përputhet me kërkesën konkrete të Autoritetit Kontraktues.Marrëveshja e paraqitur nuk mund të pranohet si dëshmi e përmbushjes së kriterit për furnizim me zhavor, për shkak se objekti i furnizimit nuk është përcaktuar në marrëveshje.

5) PRETENDIMI I PESTË : PRETENZIMI ANKIMOR LIDHUR ME QASJEN E PJESSHME NË DOKUMENTE DHE DYSHIMET PËR PARREGULLSI NË VLERËSIM

Në cilësinë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, ne kemi ushtruar të drejtën tonë ligjore për qasje në dokumentet e OE : V-SHEHU Sh.p.k pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Fushë Kosovës, në përputhje me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), të

ndryshuar dhe plotësuar.
Mirëpo, Autoriteti Kontraktues na ka lejuar qasje vetëm pjesërisht në dokumentacionin e kërkuar për Operatorin Ekonomik të shpallur fitues, **"V-Shehu" SH.P.K.** Në dokumentet e dërguara, një pjesë e konsiderueshme e të dhënave dhe identiteteve janë mbuluar (redaktuar) në mënyrë të paarsyeshme, duke pamundësuar verifikimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar apo ka shmangur dërgimin e dokumenteve kyçe që dëshmojnë kualifikimin teknik dhe profesional të operatorit fitues, e konkretisht:

- Dëshmitë e pronësisë apo posedimit të pajisjeve të kërkuara sipas Dosjes së Tenderit;
- Marrëveshjet ose kontratat e bashkëpunimit/qirasë me operatorët e tjerë ekonomikë për sigurimin e këtyre pajisjeve;
- Kërkesat për sqarime të dërguara nga Autoriteti Kontraktues tek Operatori Ekonomik fitues "V-Shehu" SH.P.K., si dhe përgjigjet/sqarimet e pranuara nga ky operator gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Kufizimi i qasjes në këto dëshmi thelbësore dhe fshehja e të dhënave pa bazë ligjore për konfidencialitet bien ndesh me Nenin 10 (Qasja në Dokumente) dhe Nenin 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) të LPP-së. Mosdhënia e plotë e dokumentacionit të lartcekur – veçanërisht e dëshmive për pajisje, marrëveshjeve me palët e treta dhe shkresave sqaruese – **ngjall dyshime serioze dhe të bazuara mbi ligjshmërinë dhe integritetin e këtij procesi të vlerësimit, pasi ekziston rreziku real se në dosjen e operatorit të shpallur fitues mund të jenë dorëzuar dokumente të rreme, të pasakta ose të pamjaftueshme** për të përmbushur kriteret e përzgjedhjes, të cilat Autoriteti Kontraktues po tenton t'i mbajë të fshehura nga shqyrtimi publik dhe nga operatorët ankues.
Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që në kuadër të shqyrtimit të kësaj Kërkese për Rishqyrtim, të rishikojë tërësisht vlerësimin e ofertës së "V-Shehu" SH.P.K., të verifikojë vërtetësinë e secilës dëshmi për pajisje dhe marrëveshjeve përkatëse, si dhe të na mundësojë qasje të plotë dhe të pakufizuar në të gjitha dokumentet e lartpërmendura në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kerkojme nga Autoriteti kontraktues **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË** që si përfundim të nxjerrë:

VENDIM

Me të cilin të vendim të aprovoj kërkesën tonë për Rishqyrtim si të bazuar të paraqitur nga *GOE* : **"VALDRINI" SH.P.K & NNP NDERTIMI**

- ✓ Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat prokurimit publik në Kosovë,
- ✓ Të anuloj njoftimin mbi vendimin e AK-së - B58

Të shpërblej me kontratë *GOE* : **"VALDRINI" SH.P.K & NNP NDERTIMI ,** sepse janë të përgjegjshëm sipas kritereve të përzgjedhjes dhe të vlerësimit dhe kanë ofruar çmim me te lirë ne mesin e tenderëve të përgjegjshëm.
Mbetemi me shpresë se Kërkesa për Ri-shqyrtim do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt, Qëndrim Kurrumeli

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime administrative, Shpenzimet e ankesës 500.00 €, Fitimi i humbur do te llogaritet nese nuk shpallemi fitues ne kete faze.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

BASHKANGJITUR GJENI FAKTET DHE ARGUMENTET LIDHUR ME PRETENDIMET TONA.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 101
Datë/Datum. 24 . 11 . 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË
OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË – KOSOVË , KOSOVO POLJE

Ne mbështetje te nenit 108/A paragrafi 10 të ligjit nr.04/L-042 për Prokurim Publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, si dhe duke u bazuar ne nenin 62 paragrafi 62.1 shkronja (d) si dhe neni 63 paragrafi 63.1 nën paragrafi 63.1.1 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të **GOE " VALDRINI" SH.P.K & NNP NDERTIMI** të datës 20.11.2026 kundër Njoftimit mbi Vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar"**me nr. te prokurimit: **612-26-8159-5-1-1,** Komuna e Fushë Kosovës (Autoriteti Kontraktues), përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit nxjerr këtë:

VENDIM

I. **Refuzohet** kërkesa për rishqyrtim e **GOE " VALDRINI" SH.P.K & NNP NDERTIMI** të datës 20.11.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar"**me nr. te prokurimit: **612-26-8159-5-1-1.**

II. **Autorizohet** Autoriteti Kontraktues – Komuna e Fushë Kosovës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.

III. **Njoftohen** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformen elektronike e-prokurimi në adresen https://e-prokurimi.rks-gov.net

IV. Vendimi hyn ne fuqi në diten e nënshkrimit.

Arsyetimi

GOE " VALDRINI" SH.P.K & NNP NDERTIMI (tutje "parashtruesi") me datën 20.11.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i kanalizimeve fekale në Fushë Kosovë dhe fshatra- projekt dy vjeçar"**me nr. te prokurimit: **612-26-8159-5-1-1**